



Në përputhje me autorizimin e dhënë me nenin 35, paragrafi 1, nënparagrafi 1.1, të Ligjit për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës, dhe nenin 46 të Rregullores së UNMIK-ut 1999/21, Bordi i Bankës Qendrore të BQK-së, në mbledhjen e mbajtur më 10 qershor 2011 miratoi

Rregullore

për Plotësimin e Rregullës së XVI për Regjistrimin, Mbikëqyrjen dhe Veprimtaritë e Institucioneve Financiare Jobankare

1. Fushëveprimi i rregullores

Kjo rregullore vlen për të gjitha institucionet financiare siç janë të përkufizuara me nenin 2 të Rregullores 1999/21, të cilat nuk janë të përfshira në ndonjë Rregullore ose Rregull tjetër të BQK-së, të cilat veprojnë në Kosovë dhe janë të përcaktuara nga Banka Qendrore Republikës së Kosovës (BQK) si institucione financiare jo-bankare.

2. Përkufizimet

Që të ndikojë në implementimin e kësaj Rregulloreje, shprehjet e përdorura do të kenë kuptim të njëjtë ashtu siç janë përkufizuar në nenin 2 të Rregullores 1999/21.

Shprehjet në këtë Rregullore do të kenë kuptimin si vijon:

“Zyra për Këmbimin e Valutave” është “Institucion Financiar” i përkufizuar në nenin 2 të Rregullores 1999/21, dhe do të thotë një person juridik apo fizik që nuk është bankë dhe merret me shitblerjen e valutave të huaja.

(b) “Zyra për Transfer të Parave” është “Institucion Financiar” i përkufizuar në nenin 2 të Rregullores 1999/21, dhe do të thotë një person juridik që nuk është bankë dhe kryen shërbimet për transfere elektronike të parave përmes një sistemi ndërkombëtar të autorizuar për transfere elektronike.

(c) “Zyra për shërbime të pagesave” është “Institucion Financiar” i përkufizuar në nenin 2 të Rregullores 1999/21, dhe do të thotë një person juridik që nuk është bankë dhe kryen shërbime të pagesave.

3. Ndalesat dhe Përjashtimet

(a) Asnjë institucion financiar jo-bankar nuk mund të veprojë në Kosovë pa pasur regjistrim valid nga ana e BQK-së.

(b) Asnjë institucion financiar jo-bankar nuk mund të përdorë në emërtimin apo reklamimin e fjalë, të cilat sipas gjykimit të BQK-së, janë të rrejshme ose mashtruese për sa i përket kushteve të tyre financiare, statusit ligjor, ose asocimit me institucionet qeveritare ose ndërkombëtare.

(c) Asnjë institucion financiar jo-bankar i regjistruar nuk duhet të përfshihet në asnjë veprimtari financiare e cila nuk i është autorizuar gjatë regjistrimit të tij në BQK pa pasur aprovimin paraprak me shkrim nga BQK-ja.

(d) Shuma maksimale për transfer në zyrat për transferin e parave për një transaksion të klientit (transfer hyrës apo dalës) është kufizuar në maksimum 10,000 Euro.

4. Regjistrimi i institucioneve financiare jo-bankare.

(a) Përgjegjësia për regjistrimin dhe mbikëqyrjen e aktiviteteve të institucioneve financiare jo-bankare në Kosovë do të jetë vetëm e BQK-së.

(b) Garancioni ose instrumentet tjera të sigurimit:

1. *Garancioni apo instrumente të tjera të sigurimit të nevojshme për Zyrën e Transferit të Parave.* Secili aplikacion për licencë operimi si Zyrë për Transferin e Parave duhet të shoqërohet me një garancion bankar, letër të parevokueshme të kredisë ose letra tjera me vlerë, të cilave ky paragraf u referohet si “letër me vlerë” në vlerën prej njëqind mijë euro (€ 100,000). Nëse aplikanti propozon të angazhohet në biznes sipas kësaj Rregulloreje në më shumë se një lokacion, atëherë vlera e letrës me vlerë do të ngritët nga pesë mijë euro (€ 5,000) për çdo lokacion, deri në një maksimum prej dyqind e pesëdhjetë mijë euro (€ 250,000). Letra me vlerë duhet të jetë në formë të pranueshme për BQK-në dhe duhet të përcaktojë BQK-në si përfitues në rast të ndonjë ankese ndaj aplikantit për të siguruar përmbushjen e obligimeve nga ana e aplikantit për sa i përket pranimin, trajtimit, transmetimit dhe pagesës së parave në lidhje me transferin e parave. Çdo kërkesë ndaj instrumentit të sigurimit mund të jetë subjekt i shqyrtimit administrativ.

2. *Depozitat në vend të letrave me vlerë.* Në vend të letrave me vlerë, aplikanti mund të deponojë para të gatshme në BQK, ose në banka tjera në Kosovë me aprovim të BQK-së, në vlerën e njëjtë por jo më të vogël se vlera e instrumentit të sigurimit. Paratë e gatshme duhet të deponohen dhe të mbahen për të siguruar obligimet e njëjta si letra me vlerë, mirëpo deponuesi ka të drejtë të përfitojë kamatën që rrjedh nga depozitat e tij.

3. Letrat me vlerë duhet të vazhdojnë të mbahen valide për një periudhë jo më pak se një vit pasi institucioni të ndërpresë veprimtarinë në Kosovë. Megjithatë, pavarësisht nga këto dispozita, BQK-ja mund të lejojë që letrat me vlerë të zvogëlohen ose të eliminohen para kohës, derisa shuma e obligimeve të papaguara të institucionit dhe paratë e patransferuara të jenë zvogëluar.

Nëse konsiderohet e domosdoshme, BQK-ja mund të kërkojë garancion ose letër tjetër me vlerë në shumën e përmendur në pikën 4 (b) (1) si kusht për licencë operimi si Zyrë e Këmbimit Valutor ose Zyrë e Shërbimit të Pagesave.

5. Aplikacionet për regjistrim

Aplikacionet për regjistrim duhet të përmbajnë formën dhe përmbajtjen e tillë siç mund të kërkohet nga BQK-ja dhe duhet të përfshijnë informacionet në vijim:

1. Aplikacionin për regjistrimin e institucionit financiar jobankar që të kryejë shërbimet ose aktivitetet financiare;
2. Emrin dhe adresën zyrtare në Kosovë;
3. Emrin e pronarit (pronareve) të ligjshëm të institucionit, informacione mbi biografinë dhe gjendjen financiare të secilit pronar, deklaratë mbi interesat apo afërsinë që lidh secilin nga pronarët e rëndësishëm, si dhe një deklaratë mbi origjinën e fondeve të kapitalit të siguruar nga secili;
4. Emrat dhe adresat e personave që do të udhëheqin institucionin dhe kualifikimet e tyre duke përfshirë informacionet biografike dhe financiare për secilin nga menaxheret e lartë dhe anëtarët e bordit drejtues si dhe një deklaratë mbi interesat apo afërsinë që lidh secilin nga menaxherët e lartë dhe anëtarët e bordit drejtues;
5. Përfaqësuesin e huaj ligjor, nëse është i aplikueshëm;
6. Kopjen e dokumentacionit të regjistrimit të biznesit;
7. Nëse është kompani aksionare, emrat dhe adresat e drejtuesve të saj dhe një kopje të statusit të saj;
8. Një plan të biznesit, duke përfshirë projeksionet e pasqyrave financiare për tri vitet e ardhshme, duke përshkruar në detaje aktivitetet e pritura nga institucionet, dhe nëse është e aplikueshme, shitjet dhe blerjet e propozuara të valutave, shërbimet e pagesave dhe mbledhjes, si dhe limitet në transaksione;
9. Një kopje të politikave dhe procedurave të brendshme për menaxhimin e rrezikut, të kontrollave të brendshme, të kontabilitetit dhe të standardeve aplikative të parandalimit të shpëlarjes së parave;
10. Listën e tarifave të përcaktuara për ofrimin e produkteve dhe shërbimeve ;
11. Dokumentin për shfrytëzimin e sistemit operativ të teknologjisë informative dhe softëare-it të aplikuar për kryerjen e shërbimeve elektronike të transaksioneve financiare;
12. Nëse institucioni aplikues është filial i një banke apo institucioni financiar që është i licencuar jashtë Kosovës, duhet një deklaratë nga mbikëqyrësi i jashtëm i institucionit amë që nuk ka ndonjë kundërshtim për sa i përket themelimit të një zyre në Kosovë;

13. Për ofrimin e shërbimit të pagesave kërkohet një kopje e marrëveshjes së nënshkruar me institucionet relevante për kryerje të shërbimeve të pagesave;
14. Informata shtesë që kandidati i konsideron të nevojshme dhe
15. BQK-ja mund të kërkojë nga aplikanti që të paraqesë informata shtesë ose plotësuese.

6. Regjistrimi dhe aprovimi

- a) Pas pranimit të aplikacionit BQK-ja shqyrton dokumentacionin e dorëzuar dhe e njofton aplikantin me shkrim se dokumentacioni është kompletuar.
- b) Pasi që të jetë kompletuar aplikacioni jo më vonë se 90 ditë BQK-ja nxjerr vendim me të cilin e miraton apo refuzon regjistrimin. Për vendimin e marrë BQK menjëherë e informon aplikatin.
- c) Regjistrimi duhet të aprovohet për një periudhë të pacaktuar kohore dhe nuk është i transferueshëm.
- d) BQK-ja aplikon tarifë për aplikim si dhe për mbikëqyrje pas regjistrimit.
- e) BQK-ja duhet të mbajë një regjistër qendror për shikim nga publiku në të cilën duhet shënuar për secilin institucion të regjistruar; emrin e institucionit, adresën e zyrës qendrore dhe informata të tjera relevante.
- f) BQK-ja mund të tërheqë regjistrimin e një institucioni financiar jobankar dhe institucioni mund të jetë subjekt i cilitdo sanksion të përfshirë në nenin 37 të Rregullores 1999/21 ose të çfarëdo sanksioni të cilin mund ta shqiptojë me urdhër.

BQK-ja mund të tërheqë regjistrimin e një institucioni financiar jobankar sipas kushteve në vijim:

1. Nëse regjistrimi është marrë në bazë të informacioneve të gabueshme, pavarësisht nëse është dhënë nga aplikanti ose ka të bëjë me vetë aplikantin, duke përfshirë të dhënat lidhur me

kualifikimet, përvojën dhe reputacionin për menaxherët dhe themeluesit e propozuar me pronësi të rëndësishme ose të parregullsive tjera materiale lidhur me aplikacionin e regjistrimit.

2. Pas kërkesës nga institucioni, dhe duke ju nënshtruar kushteve të shqiptuara nga BQK-ja.
3. Nëse institucioni ndërpret veprimtarinë për një periudhë që tejkalon një muaj pa e njoftuar me shkrim BQK-në.
4. Nëse pronarët e institucionit kanë vendosur që të shpërbëjnë ose të likuidojnë institucionin.
5. Nëse institucioni i ka paraqitur vazhdimisht BQK-së raporte me informata të rrejshme.
6. Nëse, sipas vlerësimit të BQK-së, institucioni është marrë me punë të paligjshme, me mbajtje të kontabilitetit të rrejshëm, me mashtrime ose me vepra tjera që mund t'i shkaktojnë dëme të mundshme klientëve.
7. Nëse, sipas vlerësimit të BQK-së, institucioni bankroton apo së shpejti mund të bankrotoj. Në këtë rast, BQK-ja mund të ushtroj disa apo të gjitha nga aksionet e parashtruara në Rregulloren 1999/21.

8. Nëse institucioni amë i institucionit falimenton ose i është revokuar licenca/regjistrimi.

h) Revokimi i regjistrimit të institucionit financiar jobankar nga BQK-ja u nënshtrohet kërkesave në vijim:

1. Vendimi i revokimit duhet të njoftohet me shkrim së bashku me arsyet e marrjes së vendimit të këtillë.
2. Vendimi i revokimit të regjistrimit duhet të publikohet në ueb-faqen zyrtare të BQK-së dhe në njëerën ose më shumë gazeta vendore që kanë qarkullim më të madh. Vendimi i revokimit do të hyjë në fuqi në ditën e përcaktuar nga BQK-ja; dhe

Pasi të hyjë në fuqi vendimi i revokimit të regjistrimit, institucionit të përmendur i ndalohet çfarëdo përfshirje në veprimtaritë financiare, përveç atyre veprimtarive që janë të lidhura me likuidimin e institucionit.

7. Veprimtaritë e Zyrave për Këmbimin e Valutave dhe të Zyrave për Transferin e Parave

(a) Zyrat për Këmbimin e Valutave duhet ta reklamojnë në një vend të dukshëm kursin ditor të këmbimit të valutave të huaja, për shitje dhe për blerje, për secilën valutë.

(b) Për çdo transaksion të valutave, shitje apo blerje, klientit duhet t'i jepet një dëftese me shkrim dhe institucioni duhet të mbajë një kopje. Në dëftesën me shkrim duhet të jetë i shënuar emri i klientit, data e transaksionit, kursi i këmbimit, ndonjë tarifë që është e paguar, shuma dhe lloji i valutës së këmbyer (që të dyja e pranuar dhe e dhënë).

(c) Për çdo transaksion të transferuar në mënyre elektronike, Zyrat për Transferin e Parave duhet t'ia sigurojnë klientit një dëftese me shkrim dhe institucioni duhet të mbajë një kopje. Në dëftesën me shkrim duhet të jetë i shënuar emri i klientit, data e transferit të parave, shuma e pagesës ose marrjes, lloji i valutës, kursi i këmbimit dhe tarifrat që janë paguar.

(d) Zyrat për Transferin e Parave duhet të reklamojnë ose t'u ofrojnë klientëve një kopje të listës së tarifave dhe të pagesave tjera për transferat elektronike.

(e) Operatorët e sistemeve për transferin e parave që dërgojnë ose pranojnë transfere elektronikë për të tjerët, duhet të mirëmbajnë në format elektronike të softuer-it një regjistër të transaksioneve të tilla i cili duhet të përmbajë:

1. Emrin dhe numrin e identifikimit të klientit;

2. Emrin dhe lokacionin:

(i) "Llogaria me" institucionin financiar ose vendin tjetër të destinacionit për një transfer të filluar, ose

(ii) Banka urdhëruese ose vendi tjetër dërgues i transferit elektronik të pranuar; dhe

(iii) Emri i përfituesit të transferit elektronik të filluar, ose, nëse dihet, emri i palës që bën porosinë të një transferi elektronik të pranuar.

(f) Zyrat për këmbimin e valutave, transferin e parave dhe shërbimit të pagesave duhet ta informojnë çdo muaj BQK-në për shërbimet e pagesave dhe të mbledhjes sipas formatit të cilin e rekomandon BQK-ja..

- (g) Nga Zyrat për Këmbimin e Valutave, Transferin e Parave dhe Shërbimin e Pagesave kërkohet që të jenë në pajtueshmëri me rregullën X dhe paragrafin 22 të Rregullores 1999/21 për Shpëlarjen e Parave, duke e përfshirë edhe njoftimin e BQK-së dhe autoriteteve për zbatimin e ligjit lidhur me transaksionet e mëdha dhe ato të dyshimta.
- (h) Nga Zyrat e regjistruar për Këmbimin e Valutave, për Transferin e Parave dhe Shërbimin e Pagesave kërkohet që të vendosin Certifikatën e tyre të Regjistrimit në BQK në një vend që mund të duket për të tjerët.
- (i) Nga Zyrat e regjistruar për Këmbimin e Valutave, për Transferin e Parave dhe Shërbimin e Pagesave kërkohet që t'i sigurojnë dhe t'i shfrytëzojnë pajisjet që janë të dizajnuar me qëllim që të zbulojnë bankënotat e falsifikuara.

8. Veprimtaritë e Institucioneve Financiare Jobankare

- (a) Institucioni duhet të fillojë veprimtarinë e tij brenda 60 ditësh pasi të aprovohet regjistrimi nga BQK-ja.
- (b) Veprimtaritë e institucionit duhet të ushtrohen në zyrat ose lokalet që janë të identifikuar qartë, dhe të ndara prej veprimtarive të ndonjë aktiviteti tjetër komercial ose të ndonjë ndërmarrje.
- (c) Institucioni duhet të mbajë shënimet e kontabilitetit në pajtueshmëri me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit/Raportimit Financiar. Shënimet e kontabilitetit nga institucioni duhet të jenë të ndarë nga shënimet tjera të kontabilitetit ose të veprimtarive komerciale të institucionit.
- (d) Institucioni duhet të marrë aprovimin paraprak nga BQK-ja nëse e ndërron adresën si dhe për hapjen e degëve dhe zyrave të reja.
- (e) Institucioni duhet të raportojë në BQK në bazë të formatit dhe afateve të cilat i përcakton BQK-ja.
- (f) Institucioni duhet t'u nënshtrohet ekzaminimeve periodike nga personeli i BQK-së, dhe duhet të përgatisë të gjitha shënimet, librat dhe llogaritë e veprimtarive të tyre të cilat mund të kërkohen nga personeli i BQK-së.

(g) Institucioni duhet të caktojë një auditor të jashtëm të pavarur në bazë të aprovimit paraprak me shkrim nga BQK-ja.

(h) Institucioni duhet të themelojë një sistem të kontrollit të brendshëm dhe auditimit që është e pranueshme për BQK-në.

9. Paragrafët e Aplikueshëm të Rregullores

Paragrafet e Rregullores së UNMIK-ut Nr. 1999/21 do të zbatohen nga institucionet financiare jo-bankare të adresuara në këtë Rregullore, deri në masën që ato janë të zbatueshme.

10. Rregullat e Aplikueshme

Përveç rasteve kur kjo Rregullore e cakton ndryshe, rregullat bankare në vijim të lëshuara nga BQK-ja duhet të zbatohen mutatis mutandis (me ndryshime të domosdoshme) nga institucionet financiare jo-bankare të adresuara në këtë rregull:

- Rregulla IX për klasifikim dhe provizionimin e mjeteve;
- Rregulla X për shpëlarjen e parave;
- Rregulla XI - raportimi i bankave dhe i filialeve kosovare të bankave të huaja;
- Rregulla XII për ruajtjen e shënimeve;
- Rregulla XXVI për shpalosjen dhe publikimin e normës së interesit;
- Rregulla XXVII për pajisjet minimale të sigurimit dhe procedurat;
- Rregulla XXX për sistemin e kontrollave të brendshme.

11. Hyrja në fuqi

Kjo Rregullore hyn në fuqi nga dita e miratimit.

Gazmend Luboteni

Kryetar i Bordit të BQK-së